

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTIJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#118

MARRËVESHJA/ Më shumë aktivitete kulturore për Diasporën



Vlerësimi dhe promovimi i artit dhe kulturës në Diasporën Shqiptare është qëllimi i marrëveshjes së firmosur ditën e sotme mes ministrit të Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko dhe ministres së Kulturës Elva Margariti.

Arti dhe kultura shqiptare janë pjesë e identitetit kombëtar shqiptar që na përfaqësojnë dhe në bazë të kësaj marrëveshjeje të firmosur dy ministritë angazhohen për zhvillimin e aktiviteteve të artit dhe kulturës së pjesëtarëve të Diasporës, ruajtjen e traditave kombëtare kulturore dhe nxitjen e shtrirjes së tyre.

Ngritja e Këshillit Koordinues të Artistëve në Diasporë është pjesë e kësaj marrëveshjeje ku anëtarë të saj do të jenë artistë të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në promovimin dhe zhvillimin e artit shqiptar. Procedurat dhe rregullat mbi të cilat do të krijohet Këshilli, do të bazohen në një rregullore të veçantë të miratuar nga palët.



"Apliko online për rinovimin e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

TAKIMI/ Ministri Majko me delegacionin rumun, bashkëpunim i mëtejshëm mes dy vendeve

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi sot një takim me përfaqësues të ambasadës Rumune në vendin tonë me praninë e S.T.S. Octavian Serban Ambasador, Znj Oana Ursache, sekretare shteri dhe S. Radu Cosma, këshilltar. Gjatë takimit u bisedua për marrëdhëniet mes dy vendeve, marrëdhënie të vendosura shëkuj me parë, kohë kur Rumania shërbeu si djepi i një prej lëvizjeve me të mëdha dhe më me ndikim të Diasporës Shqiptare, si vendi ku lindën, u krijuan klubet e shqiptarëve, shoqatat patriotike e shtypi me karakter kombëtar.

Ministri Majko e njohu Ambasadorin Serban me politikën e krijuara për Diasporën shqiptare dhe projektet e realizuara deri më sot. Ku theksoi rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit 2018 – 2024, dinamika e së cilës coi në ezaurimin përpara afatit kohor, dhe në miratimin e Strategjisë së re Kombëtare të Diasporës Shqiptare dhe Planin e Veprimit 2021 – 2025.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

PUBLIKIMI/ Strategjia Kombëtare e Diasporës, AKD publikon Buletinin e dytë



Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar Buletinin e dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025.

AKD ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit.

Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën.

Gjithashtu, Buletini informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikën, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të reformës shtetërore për Diasporën.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

ARSIMI/ AKD hap thirrjet për bursa për studentët shqiptar në Diasporë

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Sonila Hysi, në vijim të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 447, datë 22.07.2021 "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë", nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022" zhvilloi sot një takim me qëllim prezantimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe diskutimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin e procesit të akordimit të bursave të studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë takimit u diskutua për hapjen e thirrjes për aplikimin e shtetasve të huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë bursat e studimit nëpërmjet faqes së ambasadave, mënyrën e zhvillimit të aplikimit, si dhe dërgimin e manualit për kriteret e aplikimit.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

AKSIDENTI NE KROACI/ Ministri Majko pjesë e kortschit që priti trupat në Morinë



Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko ishte pjesë e kortschit që priti dhe përcolli trupat e viktimave të aksidentit tragjik në Kroaci.

Në Morinë u zhvillua ceremonia homazh në nderim të tyre, të cilët ishin nisur nga Gjermania drejt Kosovës me mall për vendlindjen. Tashmë ata do të prehen në banesën e fundit atje.



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

AKSIDENTI/ Këshilli Koordinues i Diasporës mesazh ngushëllues për viktimat në Kroaci

Këshilli Koordinues në Diasporë ka shprehur ngushëllimet për viktimat e aksidentit tragjik në Kroaci ku humbë jetën 10 shqiptarë të Kosovës që po udhëtonin nga Frankfurti në Prishtinë.

"Një mall për të parë familjen pas një pandemie të lodhshme, një dëshirë për të kaluar pushimet në atdhe, por që nuk u plotësua dot kurrë për 10 jetët që humbën në aksidentin e djeshëm në Kroaci."

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës janë të tronditur për këtë tragjedi që u ndodhi bashkëkombësve tanë dhe shprehin ngushëllimet më të sinqerta të afërmeve dhe miqve të viktimave.

Jemi duke e ndjekur situatën me vëmendje dhe 45 të lënduarve nga aksidenti ju urojmë shërim sa më të shpejtë e kthim sa më parë pranë të dashurve të tyre", thuhet në mesazhin e ngushëllimit.



Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu


KËRKIMI SHKENCOR/ Drejtoresha Ekzekutive e AKD zhvilloi një takim me drejtues të Institutit AlbShkenca



Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi, zhvilloi sot një takim me z. Ardian Maci, Kryetar i Institutit AlbShkenca, z. Fatos Ylli, Sekretar i Përgjithshëm dhe znj. Shpresa Tafaj, Sekretare Organizative për zhvillimin më tej të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona.

Gjatë takimit u diskutua për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor, si dhe angazhimin në nisma të përbashkëta dhe projekte në këtë fushë si dhe kthimin e trurit brenda vendit.

PROJEKTI RAJONAL/ AKD pjesë e “Marginal resilience: The circular economy model for the enhancement of territorial vocations”



Në kuadër të projektit Rajonit Puglia në Itali “Marginal resilience: the circular economy model for the enhancement of territorial vocations” u zhvillua sot takimi virtual ndërmjet palëve pjesëmarrësve në projekt.

Në këtë takim morën pjesë ing. Noè Andreano, Kryetar i Komunës Casavecchio në Puglia, znj. Iva Palmieri, përfaqësuese e Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, znj. Iris Khanaj, Agjencia Kombëtare e Diasporës, përfaqësues nga Bashkia Vlorë dhe të entit propozues të Projektit, si dhe përfaqësues të kulturës nga Rajoni Puglia.

Gjatë takimit u prezantua projekti në tërësi si dhe u diskutua mbi fazat e zbatimit konkret dhe shkallën e përfshirjes/angazhimit të palëve në projekt.

Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni

www.diasporashqiptare.al